



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 63 prot.

Kamëz, më 19.05 2020

V E N D I M:

Nr. 52 .Datë 19/05 2020

PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË LISTËN E VENDIMIT NR. 147 DATË 07.12.2020 SË SUBJEKTEVE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR NGA AKT-EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT ME NIVEL DËMTIMI, DS4 PËR RIKONSTRUKSION.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **19.05.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt – Vendim Nr.47 Datë 11.05.2021** në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit” për shkak të tërmetit të 26.11.2019; **Këshilli Bashkiak Kamëz:**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtese ne listën e vendimin nr.147 datë 07.12.2020 së subjekteve përfitues, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga grantet e rindërtimit për masën e dëmtimeve ,
 - DS4 – për rikonstrukcion.
2. Lista e subjekteve përfitues, përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij vendimi, paraqiten në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Nën/ Kryetar Këshilli
Ali Dauti**

